



GREENBRIDGE - Programi i Lëndës

Kurs mbi Aftësitë Digjitale – 2.3 Përshtatja e Trajnimeve për Aftësitë Digjitale me Nevojat e Tregut të Punës

Përshkrimi i përgjithshëm i kursit

Përshtatja e Trajnimeve për Aftësitë Digjitale me Nevojat e Tregut të Punës

Ky kurs u mundëson pjesëmarrësve të vlerësojnë dhe hartojnë kompetencat digjitale të VET (Arsimi dhe Trajnimi Profesional) në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe DigComp 2.2. Pjesëmarrësit do të mësojnë të dizajnojnë një plan praktik të Zhvillimit Profesional të Vazhdueshëm (CPD) me KPI të qarta dhe hapa për menaxhimin e ndryshimeve, duke mbështetur një kulturë digjitale të përgjegjshme.

Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të kursit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- **Përdorin të dhënat e aftësive nga burimet e tregut të punës** për të hartuar kompetencat ekzistuese të VET në raport me kornizën DigComp 2.2, duke identifikuar boshllëqet prioritare dhe mbivendosjet.
- **Dizajnojnë një plan të strukturuar për Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional (CPD)**, i cili përcakton grupin e synuar, vendos rezultate të matshme të të nxënit dhe zgjedh formatet dhe burimet e duhura të trajnimit.
- **Zhvillojnë strategji për kultivimin e një kulture digjitale reaguese**, duke përfshirë krijimin e strukturave mbështetëse dhe ndërtimin e një depoje të përbashkët burimesh për të nxitur praktika përfshirëse.

Struktura dhe përmbajtja e kursit

Moduli 1: Inteligjenca mbi Aftësitë dhe Hartimi në DigComp

Në këtë modul, pjesëmarrësit do të mësojnë të përdorin inteligjencën mbi aftësitë për të vlerësuar strategjikisht ofrimin e tyre të VET. Ata do të praktikojnë rishikimin e të dhënave të tregut të punës, si përshkrime pune dhe profile ESCO, dhe të përdorin këtë inteligjencë për të hartuar kompetencat digjitale të institucionit të tyre në kuadër të DigComp 2.2, për të identifikuar boshllëqet kritike dhe pikat e forta.



Tema 1.1 – Mbledhja e Inteligjencës mbi Aftësitë Digjitale Aktual dhe në Zhvillim

Mësoni të mbledhni dhe rishikoni të dhëna nga përshkrimet e punës dhe analizat sektoriale për të kuptuar kërkesat aktuale të tregut të punës. Fokus i veçantë do t'i ipet identifikimit të aftësive të avancuara dhe në zhvillim, si ato të lidhura me automatizimin, mekatronikën dhe ofrimin e shërbimeve digjitale.

Tema 1.2 – Hartimi i Kompetencave në DigComp 2.2

Kuptimi i strukturës së kuadrit DigComp 2.2 dhe praktikimi i hartimit të kompetencave ekzistuese ose të planifikuara të VET në fusha të ndryshme të tij.

Tema 1.3 – Analiza e Boshllëqeve dhe Mbivendosjeve

Përdorimi i rezultateve të ushtrimit për të kryer një analizë të boshllëqeve, duke identifikuar qartë se cilat kompetenca digjitale janë të pa zhvilluara ose mungojnë në ofertën aktuale të VET.

Moduli 2: Zhvillimi i një Plan CPD për Ofruesit e VET

Në këtë modul, pjesëmarrësit do të kalojnë nga analiza në veprim duke dizajnuar një plan të plotë të Zhvillimit Profesional të Vazhdueshëm (CPD). Ata do të mësojnë të strukturojnë një plan me qëllim të qartë, target grupe të paracaktuara dhe rezultate të matshme të të nxëniet të lidhura me DigComp 2.2. Gjithashtu do të vlerësojnë mënyra dhe forma të ndryshme të trajnimit për të siguruar që plani është efektiv dhe i qasshëm.

Tema 2.1 – Përcaktimi i Qëllimit të CPD dhe Grupit të synuar

Mësimi i përcaktimit të kontekstit dhe objektivave të një plani CPD bazuar në inteligjencën mbi aftësitë dhe të përcaktojnë qartë audiencën për një ofrim të personalizuar.

Tema 2.2 – Shkrimi i Rezultateve të Matshme të të Nxëniet

Praktikimi dhe krijimi i rezultateve efektive të të nxëniet duke përdorur folje vepruese (p.sh., identifikoni, aplikoni, krijoni), duke siguruar që çdo rezultat lidhet me një fushë specifike kompetence në DigComp 2.2.

Tema 2.3 – Zgjedhja e Formave të Trajnimit dhe Burimeve

Rishikimi dhe zgjedhja e formave të përshtatshme trajnimit (p.sh., micro-learning, punëtori) përmes formave të ndryshme (online, hibrid), duke identifikuar burimet dhe nevojat për qasje.

Moduli 3: Kultivimi i një Kulture Digjitale të Përgjegjshme

Në këtë modul, pjesëmarrësit do të eksplorojnë strategjitë për integrimin e kompetencës digjitale në kulturën e institucionit të tyre. Ata do të shqyrtojnë modele të ndryshme për përmirësimin e aftësive të stafit dhe do të mësojnë të krijojnë struktura mbështetëse esenciale, si kampionët digjitalë dhe kanalet e ndihmës. Moduli përfundon me planifikimin e një depoje qendrore burimesh për të promovuar praktika të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse digjitale në të gjithë organizatën.



Tema 3.1 – Modele për Përmirësimin e Aftësive Digjitale

Eksplorimi dhe krahasimi i modeleve të ndryshme të zhvillimit profesional, duke përfshirë rifreskime të shkurtra, kurse online formale, mentorim nga kolegët dhe punëtori praktike.

Tema 3.2 – Ndërtimi i Strukturave Mbështetëse të Qëndrueshme

Mësimi për krijimin e një sistemi mbështetës efektiv përmes një rrjeti kampionësh digjitalë, kanaleve të dedikuara ndihmëse dhe grupeve të mbështetjes nga kolegët.

Tema 3.3 – Krijimi i një Depoje Qendrore Burimesh

Planifikimi për krijimin një depoje të përbashkët për mjetet digjitale, udhëzimet e praktikave më të mira dhe materialet mësimore për të siguruar konsistencë dhe për të promovuar praktika gjithëpërfshirëse.

Tema 3.4 – Strategjitë për Bashkëpunim me Industrinë

Eksplorimi i metodave praktike për të ndërtuar dhe mbajtur partneritete të forta me bizneset lokale. Temat përfshijnë krijimin e bordeve këshilluese industrisë, dizajnimin e përbashkët të moduleve të kurrikulës dhe krijimin e mundësive për leksione të ftuara për të siguruar përshtatjen e vazhdueshme me nevojat e tregut të punës.

Aktivitete të të nxënit dhe mësimdhënies

- Mësim online me ritëm të vetëvendosur me materialet e siguruar; duke përfshirë tekst, imazhe dhe video të gjeneruara nga inteligjence artificiale
- Seanca me ligjërues për të prezantuar materialin e ri.
- Diskutime (Seanca trajnimi me ligjërues)

Orari dhe koha e kursit

	Sesioni i trajnimit me ligjëruesin (Fizikisht ose Online)	Mësim i pavarur
Moduli 1	1 orë	30 min
Moduli 2	1 orë	30 min
Moduli 3	1 orë	30 min
Total:	3 orë	1 orë dhe 30 min

Metodat e vlerësimit

- Një pyetësor vetë-vlerësimi do të ofrohet pas çdo moduli, duke përfshirë pyetje me një përgjigje të vetme.



Co-funded by
the European Union



TECH
LGARIA



THE
BALKAN
FORUM



DIGITAL
FABRICATION
LABORATORY

